

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me objekt “Mbi organizimin, drejtimin dhe zbatimin e programit vjetor të monitorimit të mjedisit Mbi organizimin, drejtimin dhe zbatimin e programit vjetor të monitorimit të mjedisit” për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 68 datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 356/7 datë 30.06.2014, dërguar Z. Julian Beqiraj, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. AKM, në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar nga Ministria e Mjedisit për vitin 2014, të marrë masa për hartimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me kreun X, seksioni 1, pika 4, neni 59 të ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” si dhe përcaktimin e kriterëve për rekrutimin e personelit, referuar strukturës organizative.

Menjëherë

2. Në programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, të pasqyrohet mënyra e dorëzimit dhe përpunimit të të dhënave mbi mjedisit, nga institucionet të cilat përcaktohen në kreun 3, të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Mbi rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit” si dhe të bashkëpunojë me ministrinë përkatëse, për të përcaktuar të dhënat dhe treguesit që ato do të grumbullojë për mjedisin, si dhe me organet e qeverisjes vendore, për të përcaktuar të dhënat e treguesve që ato kanë në administrim.

Deri më datë 30.09.2014

3. AKM të respektojë afatet e përcaktuara në pikën 4, kapitulli X, të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009, për të lidhur kontratat e shërbimit brënda muajit dhjetor të çdo viti dhe përveç treguesve mjedisorë të kontratuar me subjektet e specializuara për monitorimin e mjedisit, t’ju kërkojë organeve qëndrore dhe institucioneve monitoruese, monitorimin e treguesve që nuk janë përfshirë në kontrata.

Deri më datë 30.12.2014

4. Në zbatim të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, AKM të sigurojë të dhëna në përputhje me kreun 4, të VKM nr.1189 datë 18.11.2009, si dhe të pasqyrojë në këtë program, mënyrën e kontrollit të cilësisë së analizave të kryera për monitorimin e mjedisit, nga subjektet kontratuese dhe subjektet shtetërore dhe ato të pajisura me leje mjedisore.

Vazhdimisht

5. Në zbatim të pikës 1, kreu 4, të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009, për hartimin e Raportit Vjetor të gjendjes së mjedisit, AKM të sigurojë të dhëna gjithëvjetore të pjesëve përbërëse të mjedisit, me qëllim që përfundimet të jenë të besueshme dhe të vlefshme për organet vendimë marrëse dhe politikëbërëse.

Në vazhdimësi

6. Në zbatim të pikës 2, kreu 4, të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009, AKM të hartojë regjistrat përkatës me qëllim regjistrimin e të dhënave të shkarkimeve dhe transformimin e ndotësve në mjedis si dhe krijimin e sistemit të të dhënave mjedisore.

Në vazhdimësi

7. Në zbatim të nenit 45, 46, 47 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, AKM të publikojë në vazhdimësi, në forma të ndryshme, të dhënat e për mjedisin, në mënyrë që të realizojë të drejtën e publikut për informim mjedisor.

Menjëherë

8. Në zbatim të pikës 5, 6, neni 6, ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, Agjencia të hartojë dhe aplikojë një analize të hollësishme në përcaktimin e TMD-ve, të marrë masa për ngritjen e sistemit të informacionit mbi dokumentet e referencës për TMD-të, si dhe ti publikojë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të internetit të AKM-së.

9. Në kushtet e vëna në lejet mjedisore të tipit A (për mbetjet e gazta), AKM të zbatojë nenin 15, të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 dhe të vendosë kushte të hollësishme për shkarkimin e mbetjeve të gazta si dhe lartësia e oxhakut duhet të llogaritet në mënyrë të tillë që të ruajë shëndetin e njeriut.

Menjëherë

10. AKM të bëjë publike informacionet, lidhur me instalimet e kategorive A dhe B, të cilat duhet të ishin pjesë e sistemit të informacionit mjedisor, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Menjëherë

11. Sektori i Lejeve Mjedisore, të vendosë e të plotësojë kushtet në lejet mjedisore sipas shtojcave 1-10, të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” si dhe të plotësojë dosjet e subjekteve që disponon në versionin elektronik, për të krijuar një data bazë të plotë për subjektet e pajisur me dokumentacion mjedisor.

Menjëherë

12. Në lejet mjedisore, të detajohen në mënyrë konkrete kushtet për respektimin e normave në çdo nyje shkarkuese të veprimtarisë dhe në total, duke cituar normat e shkarkimeve. Të vendosen kërkesa konkrete për zbatimin e programit të monitorimit, duke përfshirë treguesit e gjendjes së ndikimit në mjedis, stacionet e marrjes së mostrave dhe frekuencën e matjes së tyre, metodën e llogaritjes, formatet e paraqitjes dhe regjistrimit të të dhënave.

Menjëherë

13. Në lejet mjedisore, të paraqiten me hollësi sasia dhe volumi i shkarkimeve që autorizon çdo leje, ku të paraqitet çlirimi dhe dalja në mjedis në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e lëndëve të gazta, të ngurta, të lëngëta si dhe energjisë, vibracioneve e zhurmave nga një ose disa

burime të palëvizshme, në lëvizje ose të shpërndara, të specifikuara këto sipas veçantisë së çdo projekti.

Menjëherë

14. Formulimi i kërkesave dhe i kushteve të vendosura në lejet mjedisore, të jenë specifike, në varësi të veprimtarisë së subjektit, në mënyrë që kërkesat dhe kushtet e vendosura, të jenë të thjeshta për tu kontrolluar nga organet, të cilat kryejnë kontrollet dhe inspektimet si dhe për tu monitoruar edhe nga vetë subjektet.

Menjëherë

15. Në mbledhjet e ardhshme të Komisionit për shqyrtimin dhe dhënien e lejeve mjedisore, anëtarët e komisionit para pjesëmarrjes në mbledhje të studiojnë individualisht kërkesat dhe në mbledhjet e komisionit të shprehen për zbatimin ligjor të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e ndryshme që aplikojnë për tu pajisur me leje mjedisore.

Menjëherë

16. AKM të vazhdojë përpjekjet e saj në mënyrë që aplikimet për VNM të futen në QKL në fushën “VNM” sipas përcaktimit në nenin 10 “Paraqitja e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi” të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe jo në fushën “Leje mjedisore” siç është vepruar deri tani.

Menjëherë

17. AKM të ushtrojë funksionin e saj në bazë të përcaktimeve në nenin 11, të ligjit nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” sipas të cilit në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, AKM-ja të marrë vendimin nëse një projekt duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

Menjëherë

18. Sektori i VNM-së, pasi i përcjell dosjet bashkë me mendimet Sektorit të Lejeve Mjedisore, të mbajë çdo informacion dhe dokumentacion në një bazë të dhënash lidhur me numrin e saktë të procedurave të kryera dhe numrin e saktë të VNM-ve të shqyrtuara, që nga koha kur këtë procedurë ka filluar ta kryejë AKM, numrin e rasteve të kthyer për tu rishqyrtuar dhe arsyet kryesore pse ato janë gjykuar si të pa rregullta. Kjo bazë të dhënash do të shërbejë këtij sektori ndër të tjera edhe për përmirësimin e procedurave më tej si dhe për të patur një informacion të saktë dhe të plotë si sektor më vete.

Menjëherë

19. AKM të përfshijë në dosjet e subjekteve të dhëna që vërtetojnë zbatimin e nenit 11 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit mjedis”, sipas të cilit në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, AKM-ja të marrë vendim nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

Menjëherë

20. AKM, të marrë masat e nevojshme që kontratat e monitorimit nënshkruar me institucionet përkatëse, të kenë bashkëlidhur praktikën për llogaritjen e shpenzimeve të programuara si dhe grafikun e monitorimit, si pjesë e kontratës.

Vazhdimisht

21. AKM, të marrë masat për arkëtimin e diferencave të pa përdorura, ose të pajustificuara me dokumentacionin justifikues, për shpenzimet e kryera sipas kontratave të monitorimit që do të lidhen me institucionet përkatëse.

Vazhdimisht

22. AKM, në zbatim të Kreut V, neni 12, të Kodit të Punës të nënshkruajë kontratat individuale të punës si me punonjësit aktualë ashtu edhe me punonjësit që do të rekrutohen, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet midis palëve.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. a) Mbështetur në nenin IX “Pagesat” të kontratave të nënshkruara me institucionet për monitorimin e treguesve mjedisorë të merren masa nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Mjedisit, për arkëtimin e shumës prej **503,760 lekë**, e përfituar padrejtësisht dhe mbetur pa arkëtuar nga auditimi i ushtruar për vitet 2010 - 2011, nga institucionet si më poshtë:

- [REDAKTUAR] **201,300 lekë**;
- [REDAKTUAR] **302,460 lekë**;

1. b.) Të kërkohej në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **456,802 lekë**, mbetur të pa arkëtuar nga auditimi i ushtruar për vitet 2010 – 2011, përfituar padrejtësisht nga:

- zj. [REDAKTUAR] ish Drejtor AMP. në vlerën **425,686 lekë**;
- z. [REDAKTUAR] ish Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve, në vlerën **31,116 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Tiranë, të kryejë kontabilizimet dhe të kërkojë në rrugë ligjore, shpërblimin e dëmit në vlerën **1,183,847 lekë**, në mënyrë analitike për çdo institucion, sipas kontratave të nënshkrura si më poshtë:

2.1. Vlera prej **438,375 lekë**, e përfituar padrejtësisht nga [REDAKTUAR] për vitet 2012-2013, nga kontratat e monitorimit, e përbërë nga vlera e financimit për t’u kthyer, e pa përdorur/e pa justifikuar dhe penalitet, për mos respektim të kushteve të kontratës.

2.2. Vlera prej **27,698 lekë**, e përfituar padrejtësisht nga [REDAKTUAR] nga kontratat e monitorimit, vlerë e pa justifikuar/e pa përdorur.

2.3. Vlera prej **413,987 lekë** e përfituar padrejtësisht nga [REDAKTUAR], Tiranë, nga kontratat e monitorimit, vlerë e pa justifikuar/e pa përdorur.

2.4. Vlera prej **303,787 lekë**, e përfituar padrejtësisht nga kontratat e monitorimit, nga [REDAKTUAR] Vlera, e pajustificuar, pasi është proceduar jashtë afatit të përfundimit të kontratës.

C. MASA DISIPLINORE

Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Pwrfundimtar të Auditimit, janë konstatuar përgjegjësi të natyrës drejtuese dhe menaxhuese dhe zbatuese të ligjit, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore:

“Largim nga detyra”

Për:

1. z. [REDACTED] në cilësinë e Kryetarit të Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve;
2. z. [REDACTED] në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Lejeve Mjedisore;
3. z. [REDACTED] në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Gjëndjes dhe Cilësisë së Mjedisit;
4. znj. Rozeta Shira, në cilësinë e Drejtores së Drejtorisë së Informacionit dhe dhe Menaxhimit të të dhënave;
5. z. [REDACTED] në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Inovacionit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
6. zj. [REDACTED] në cilësinë e specialistes në Sektorin e GIS, IT, dhe SIM;
7. z. [REDACTED] në cilësinë e specialistit në Sektorin e GIS, IT, dhe SIM;
8. z. [REDACTED] në cilësinë e specialistit në Sektorin e Inovacionit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Për personat e sipërpërmendur nuk rekomandojmë masë disiplinore, duke e konsideruar masën të ezauruar, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë subjekt.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Mimoza Lloji, Agron Maksutaj, Keida Muça, Lolita Baholli, Almen Alemi më tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT